



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË  
NJËSIA E PROKURIMIT**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot

Vlorë, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ 2024

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT  
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Për: **Bashkimin e Operatorëve (BOE)**

**LUEM TRADE & CONSTRUCTION TRADE & CONSTRUCTION shpk me Nuis L42215023A dhe VELLEZERIT HYSA shpk me Nuis K12911201C**

Seli/Zyra Qendrore:

Tirane, Rruga "Nikolla Tupe", Pallati I.E, Kati 1, Ap.4

Adresa:

Tirane, Vore, Rruga Muçaj, Magazine me Zone kadastrale Nr.2726, Numri i pasurise 89/59, Volumi 5 faqe 209

Elbasan, Klos Banje Fshati Banje e Re, Klos, Bashkia Cerrik, buze lumit Devoll, 500 m nga ura mbi lumin Devoll, zona kadastrale nr.1093, pasuria nr.31/50

Adresa:

1) Durres, Porto Romano, Pasuria nr. 96, Zona kadastrale 3184

2) Elbasan, Shushice, Shelcan, Fshati Shelcan, nr 1304 dhe 369/5 prane tuneleve

3) Elbasan, Gracen, Gjorm, Zona Minerare Nr.356/1, Objekti "Gjorm".

Procedura e prokurimit/lotit: **PROCEDURE E HAPUR, PUNË**

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **Ref-84804-10-23-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksion i Palestrës (së qytetit) Multisportive të Ekipit Flamurtari”**.

**60 (gjashtëdhjetë) ditë nga data e lidhjes së kontratës.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. B-93 shpk me Nuis J62903508R**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **13,020,315.70 (trembëdhjetë million e njëzetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë/70) lekë pa TVSH;**

**2. AVDULI shpk me Nuis J66703306O**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **13,762,670.00(trembëdhjetë million e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH;**

**3. Bashkimin e Operatorëve (BOE)**

**Shendelli shpk me Nuis K07924803N dhe S P E K T R I shpk me Nuis J62903555F**Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **14,186,955.00 (katërmëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;**

**4. Bashkimin e Operatorëve (BOE)**

**“SARDO” shpk me Nuis K13120402W dhe LIQENI VII shpk me Nuis K01730502W**  
Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **15,476,075.00(pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;**

**5.LIS KONSTRUKSION shpk me Nipt K66613407H**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **16,138,742.00 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dyzetë e dy) lekë pa TVSH,**

**6. Bashkimin e Operatorëve (BOE)**

**LUEM TRADE & CONSTRUCTION TRADE & CONSTRUCTION shpk me Nuis L42215023A dhe VELLEZERIT HYSA shpk me Nuis K12911201C**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **16,498,999.00** (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH,

#### **7. “T & XH” shpk me Nuis L72121504I**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **16,699,250.00** (gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

#### **8. Bashkimin e Operatorëve (BOE)**

**“ABG Ndertim” shpk me Nuis K03816401O dhe “EVEREST” shpk me Nuis J78311921L**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **16,936,619.23** (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë.23) lekë pa TVSH.

*Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:*

##### **1. B-93 shpk me Nuis J62903508R**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **13,020,315.70** (trembëdhjetë million e njëzetë mijë e treqind e pesëmbëdhjetë/70) lekë pa TVSH;

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim **2.3.5** Numri mesatar i punonjësve duhet të jetë jo më pak se **69** (gjashtëdhjetë e nëntë) punonjës për periudhën **Korrik 2023– Shtator 2023**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Korrik 2023– Shtator 2023**.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik 2023– Shtator 2023**.

***Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.***

Nga verifikimi i vetdeklarimit të bërë në formularin përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se operatori ekonomik ka deklaruar se disponon për muajin Korrik 12 punonjës, për muajin Gusht 14 punonjës dhe për muajin shtator 14 punonjës pra për 3 muajt e kërkuar deklarohen në dispozicion të operatorit ekonomik rreth 13.5 punonjës duke mos plotësuar numrin e punonjësve të kërkuar nga autoriteti kontraktor. Pra janë deklaruar afersisht 14 punonjës nga 69 të kërkuar duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.5.

## 1. Ne kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4 percaktohet:

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar si staf teknik te pajisur me certifikata te sigurimit teknik te leshuara nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Korrik 2023 – Shtator 2023** minimalisht si më poshtë:

- Punonjës Teknik ndërtimi 2 (dy)
- Punonjës hidraulik 2 (dy)
- Punonjës murator 3 (tre)
- Punonjës Bojaxhi 1 (nje)
- Punonjës Saldator 3 (tre)
- Punonjës Hekurthyes 2 (dy)
- Punonjës Elektracistë 3 (tre)
- Punonjës Pllakashtrues 3 (tre)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Certificate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuara nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

Tab.1

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve punes	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifika profesionale	Institucioni/Subjekt certifikues	Data vlefshmerise certifikat profesionale
----	--------------	------------	-------------------------------------	--	----------------------------------	---

**Kriteri sipas pikes 2.3.4 do të përmbushet nga OE me anë të plotësimit të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit dhe tabelës Tab.1. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” operatori ekonomik B 93 nuk ka deklaruar se disponon stafin teknik sikunder percaktuar ne pikën 2.3.4 te kriterëve te vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pra nuk ka deklaruar punonjës, teknik ndertimi, hidraulik, murator, bojaxhi, saldator, hekurthyes, elektracistë, pllakashtrues.

Sa më sipër konstatuar operatori ekonomik B 93 nuk ploteson kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4.

## 2. Ne kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.2 percaktohet:

**2.3.2** Operatori Ekonomik ofertues për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të zoterojë Liçenca Profesionale të lëshuar nga MPPT/MTI ose nga institucionet e autorizuara me ligj si më poshtë:

**Për punimet e përgjithshme të ndërtimit kompania duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

- **NP-1 A** (*Punime gjurmimi në tokë*)
- **NP-2 A** (Ndërtime civile dhe industriale)
- **NP-3 A** (*Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada*)
- **NP-7 A** (*Ujësjiellësa, gazsjellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje*)
- **NP-12 A** (*Punime të inxhinierisë së mjedisit*)

**Për punimet speciale të ndërtimit duhet të ketë liçensat e mëposhtme:**

- **N.S - 1 A** Punime për prishjen e ndërtimeve;
- **N.S - 2 A** Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S -4 A** Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese;
- **N.S - 14 A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV;

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licencave profesionale sipas legjislacionit në fuqi;

*Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës. Në rast të shpalljes fitues të një operatori ekonomik të huaj, ky i fundit do të ekuivalentojë licencën sipas legjislacionit përkatës përpara zhvillimit të fazës së dytë të tenderit.*

Operatori ekonomik ka paraqitur licencën NZ.0747/29, date 18.10.2023. Nga verifikimi i kategorive të licences konstatohet se operatori ekonomik B-93 nuk disponon licence me kategorinë NP-12 (punime të inxhinierisë së mjedisit) duke mos plotësuar kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik, pika 2.3.2.

### **3. Ne kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.7 përcaktohet:**

**2.3.7** Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë minimalisht 2 (dy) punonjës manovrator . Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmitë e aftësisë profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “*Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre*”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT si dhe plotësimin e të dhenave për punonjësit sa me sipër në formatin e deklaratës së kërkuar në pikën 2.3.4. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6,*

të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë per punonjesit e kerkuar si me sipër, emer/mbiemer, numrin dhe daten e deshmise së aftësisë profesionale.

Sikundër përcaktuar në pikën 2.3.7 ky kriter do të përmbushet nëpërmjet plotësimit të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” operatori ekonomik B-93 nuk ka deklaruar se disponon punonjës manovratorë sikunder përcaktuar ne pikën 2.3.7 te kriterëve te vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

Sa më sipër konstatuar operatori ekonomik B-93 nuk ploteson kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.7.

#### **4. Ne kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.8 percaktohet:**

Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë pjesë të stafit të punësuar **1(një)Ekspert zjarrëfikës**, të cilin duhet ta deklarojnë seksionin përkatës të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit sipas shtojcës 8 në DST, si dhe në rast se kualifikohet, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, duhet të paraqesë dokumentacionin: Kontratë pune (të vlefshme) dhe Çertifikatën në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi lëshuar nga MZSH.

Sikundër përcaktuar në pikën 2.3.8 ky kriter do të përmbushet nëpërmjet plotësimit të Formularit Përmbledhës të Vetdeklarimit. Nga verifikimi i formularit përmbledhës të vetdeklarimit konstatohet se në Seksionin B DEKLARATË “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate” operatori ekonomik B-93 nuk ka deklaruar se disponon punonjës Ekspert Zjarrëfikës sikunder përcaktuar ne pikën 2.3.8 te kriterëve te vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik.

Sa më sipër konstatuar operatori ekonomik B-93 nuk ploteson kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.8.

#### **5. Ne kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.14 percaktohet se operatori ekonomik duhet te përcaktojë makinerite si më poshtë:**

6. Nr	Lloji i makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia
1	Kamiona vetshkarkues , kapaciteti total mbajtës minimumi 5 ton	në pronësi ose me qera	copë	1
2	Kamioncine me kapaciteti total mbajtes deri ne 3.5 ton	në pronësi ose me qera	cope	1
3.	Eskavator me goma	në pronësi ose me qera	cope	1
4	Depozite uji mbi 1000 litra	në pronësi ose me qera	copë	2

5	Vinç kulle	në pronësi ose me qera	cope	1
6	Betoniere	në pronësi ose me qera	copë	2
7	Matrapik	në pronësi ose me qera	copë	1
8	Gjenerator	në pronësi ose me qera	copë	2
9	Elektrosaldatrice	në pronësi ose me qera	copë	1
10	Trapan	në pronësi ose me qera	cope	1
11	Pompe suvatimi	në pronësi ose me qera	cope	1

Mjete dhe paisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier"(i ndryshuar) me VKM-në nr.563, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndeti për përdorimin e paisjeve mbrojtëse individuale në vendin e punës", dhe VKM-në nr.564, datë 03.07.2013 "Për miratimin e rregullores për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës" si më poshtë vijon:

- Kokore mbrojtëse minimumi 60 (gjashtedhjetë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 (pesë ) copë
- Karroca dore minimumi 5(pesë ) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 (dhjetë) copë
- Fikse zjarri 5 (pesë) copë
- Jelekë minimum 60 (gjashtedhjetë) copë

**Ky kryter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit.**

Nga verifikimi i Seksionit të Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit shtojca C: DEKLARATË "Për disponimin e mjeteve/pajisje/makinerive të nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate" konstatohet se operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon:

- Kamioncine me kapaciteti total mbajtes deri ne 3.5 ton
- Eskavator me goma
- Vinç kulle
- Kokore mbrojtëse
- Komplet i ndihmës së shpejtë
- Karroca dore
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt
- Fikse zjarri 5 (pesë) copë
- Jelekë minimum 60 (gjashtedhjetë) copë



Sa më sipër operatori ekonomik nuk ka deklaruar se disponon një pjesë të makinerive të kërkuara duke mos plotësuar në tërësi kapacitetin teknik në lidhje me makineritë dhe pajisjet e kërkuara nga autoriteti kontraktor për realizimin e objektit të prokurimit.

## **2. AVDULI shpk me Nuis J667033060**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **13,762,670.00(trembëdhjetë million e shtatëqind e gjashtëdhjetë e dymijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH;**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE ka deklaruar Z. Brahim Brahimi I cili nuk rezulton fare në listepagesat e tij.

Z. Ydai Caushaj, ka mosperputhje datash në certifikaten e dorezuar.

OE rezulton të ketë debi pranë Drejtorisë së Tatimeve sipas korrespondences që në si Autoritet Kontraktor kemi patur bazuar në akt-marreveshjen e dorezuar nga OE, gjithashtu mungon vërtetimi i gjëndjes gjyqësore I Z.Arben Avduli në dokumentacionin fizik të dorezuar.

## **3. Bashkimin e Operatorëve (BOE)**

**Shendelli shpk me Nuis K07924803N dhe S P E K T R I shpk me Nuis J62903555F**Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **14,186,955.00 (katërbëdhjetë milion e njëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim **2.3.7**Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar në stafin e shoqërisë minimalisht 2 (dy) punonjës manovrator . Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmite e aftësisë profesionale (DAP), lëshuar nga D.P.SH.T.RR që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “*Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtime dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre*”, miratuar me urdhërin nr. 200, datë 16.5.2019, të Ministrisë të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT si dhe plotësimin e te dhenave për punonjesit sa me sipër në formatin e deklarates se kerkuar në piken 2.3.4.Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar , përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.*



**Në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Deklarata B, operatorët ekonomik duhet të deklarojnë për punonjësit e kërkuar si më sipër, emer/mbiemer, numrin dhe datën e dëshmise së aftësisë profesionale.**

Nga verifikimi i Formularit Përmbledhës të vetëdeklarimit të paraqitur nga operatori ekonomik “Shëndelli” shpk nuk ka deklaruar punonjësit manovratorë sikundër kërkuar në dokumentat e tenderit pasi për këta punonjës nuk ka deklaruar numrin dhe datën e dëshmise të aftësisë profesionale duke mos plotësuar në tërësi kriterin përcaktuar në pikën 2.3,7 të dokumentave të tenderit.

**1. Ne kriteret e vecanta për kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.1, germa a percaktohet:**

**Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “Spektri” shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër, ka dorëzuar: -Formularin përmbledhës së Vetëdeklarimit.

Referuar Formularit të Vetëdeklarimit të plotësuar nga OE dorëzuar SPE nga subjekti “Spektri” SHPK, nga komisioni i vlerësimit të ofertave konstatohet se nuk janë plotësuar në mënyrë korrekte të gjitha fushat e kërkuara në formular, pasi nuk është plotësuar Seksioni D. Deklaratë mbi Mosangazhimin e Kapaciteteve Teknike në Kontrata Te Tjera ne lidhje me stafin teknik te shoqërisë.

Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pika 1 dhe gërma “i” e pikës 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.

**Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarin, si më poshtë vijon:Nëse kërkohet, stafi teknik i poshtëshënuar: Z.**

\_\_\_\_\_, me profesion \_\_\_\_\_, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e \_\_\_\_\_, etj ., i deklaruar në këtë procedurë prokurimi, nuk është i angazhuar në asnjë kontratë apo punëmarrje tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Referuar kriterit përcaktuar në pikën 2.3.3 të kriterëve të vecanta për kualifikim është përcaktuar se inxhinieret e deklaruar nuk duhet të jenë të angazhuar në kontrata të tjera dhe duhet të jenë të angazhuar vetëm në këtë objekt. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikisht në kriterin 2.3.3 se:

**Kriteri sipas pikës 2.3.3 do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit . Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë**

**pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.**

Komisioni i Vlerësimit të ofertave sqaron, se operatori ekonomik është përgjegjës për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës dhe në përgatitjen e saj duhet të konsultohet me të gjitha udhëzimet, formularët, termat dhe specifikimet në Dokumentet e Tenderit. Është qartësisht e kuptueshme sa më sipër përcaktuar se autoriteti kontraktor në hartimin e këtij kriteri kualifikues ka kërkuar që të plotësohet me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje me këto kërkesa. Pra, kriteri 2.3.3 i sipërcituar nuk është përmbushur nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit nga operatori ekonomik, sipas shtojcës 8 të DST pasi në këtë Formular nuk është plotësuar Seksioni D mbi angazhimin e punonjësve.

**2. Ne kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.3.4 percaktohet:**

**2.3.4** Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar si staf teknik te pajisur me certifikata te sigurimit teknik te leshuara nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise, si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Korrik 2023 – Shtator 2023** minimalisht si më poshtë:

- Punonjës Teknik ndërtimi 2 (dy)
- Punonjës hidraulik 2 (dy)
- Punonjes murator 3 (tre)
- Punonjës Bojaxhi 1 (nje)
- Punonjës Saldator 3 (tre)
- Punonjës Hekurthyes 2 (dy)
- Punonjës Elektracistë 3 (tre)
- Punonjës Pllakashtrues 3 (tre)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Certificate te sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) e cila te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise
- Operatori ekonomik te paraqes deklarate ne lidhje me stafin qe disponon sipas formatit te meposhtem:

**Tab.1**

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve punes	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/Subjekti certifikues	Data vlefshmerise se certifikates profesionale
----	--------------	------------	-------------------------------------	---	-----------------------------------	--

**Kriteri sipas pikës 2.3.4 do të përmbushet nga OE me anë të plotësimit të Formularit**

**Përmbledhës së Vetëdeklarimit dhe tabelës Tab.1.** Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

***Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.***

Nga verifikimi i dokumentacionit të operatorit ekonomik “Spektri” shpk konstatohet se operatori ekonomik ka paraqitur tabelën 1 për stafin teknik por nuk ka deklaruar sikunder kerkuar datën e vlefshmerisë së certifikatës profesionale për stafin teknik të kërkuar.

Kërkesat për kualifikim, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Sa më sipër operatori ekonomik nuk plotëson në tërësi sikundër kërkuar në dokumentat e tenderit kriterit përcaktuar në pikën 2.3.4.

#### **4. Bashkimin e Operatorëve (BOE)**

**“SARDO” shpk me Nuis K13120402W dhe LIQENI VII shpk me Nuis K01730502W**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **15,476,075.00(pesëmbëdhjetë milion e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH;**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim **2.3.5** Numri mesatar i punonjësve duhet të jetë jo më pak se **69 (gjashtëdhjetë e nentë) punonjës** për periudhën **Korrik 2023– Shtator 2023**. Për të vërtetuar këtë operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Vërtetim nga Sigurimet Shoqërore/ose Administrata Tatimore për periudhën **Korrik 2023– Shtator 2023**.
- b) Listëpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën **Korrik 2023– Shtator 2023**.

***Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari ne klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit***

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Liqeni VII” sh.p.k. & “SARDO” sh.p.k. rezulton se, është paraqitur dokumenti Marrëveshje Bashkëpunimi, ndërmjet shoqërive “Liqeni VII” sh.p.k. & “SARDO” sh.p.k., nga ku shoqëria “SARDO” sh.p.k. merr përsipër të realizojë **77.5254707 %** të punimeve dhe shoqëria “Liqeni VII” sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë **22.4745292%** të punimeve. Gjithashtu në kontratën e bashkëpunimit është përcatuar se operatori ekonomik “SARDO” shpk do të jetë përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Në Kreun XI, neni 88, “*Bashkimi i operatorëve ekonomikë*”, pika 3, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, e ndryshuar parashikohet: Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. **Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

Bashkimi i operatorëve ekonomikë, “Liqeni VII” sh.p.k. & “SARDO” sh.p.k. në përmbushje të kriterit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor në dokumentat e tenderit, kriteret e vecanta kualifikim pika 2.3.5 ka vetdeklaruar numrin e punonjësve ku operatori ekonomik “SARDO” shpk vetdeklaroi se ka të punësuar 38 punonjës.

Nga verifikimi i formularit të vetdeklarimit në lidhje me numrin e punonjësve komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se operatori ekonomik “SARDO” sh.p.k. nuk e ka përmbushur këtë kriter sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, në përputhje me përqindjen e përcaktuar më sipër të pjesëmarrjes në bashkëpunim aq më tepër kur ky operator është edhe përfaqësuesi i bashkimit të operatorëve dhe ka një përqindje të konsiderueshme të punëve të marra përsipër në kontratën e bashkëpunimit.

Nga sa më sipër operatori ekonomik “SARDO” shpk në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim duhet të dispononte dhe të vetdeklaronte 53 punonjës ndërkohë që në formularin përmbledhës të vetdeklarimit ka deklaruar se disponon 38 punonjës duke mos plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për numrin e punonjësve pasi nuk plotëson numrin e punonjësve në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim

Sqarojmë se, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit Komisioni i vlerësimit të ofertave konkludon se, anëtari e bashkimit të operatorëve ekonomikë “SARDO” sh.p.k. nuk plotëson kapacitetin teknik në lidhje me numrin e punonjësve në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, si dhe në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkëpunim.

Në nenin 77, pikat 4 dhe 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të

përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës. 5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

## 5. LIS KONSTRUKSION shpk me Nipt K66613407H

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme **16,138,742.00 (gjashtëmbëdhjetë milion e njëqind e tridhjetë e tetë mijë e shtatëqind e dyzetë e dy) lekë pa TVSH,**

Nga komisioni i vlerësimit të ofertave referuar nenit 93 të LPP si dhe në mbështetje të VKM Nr. 285, dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Kreu X neni 82, nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë procedurë prokurimi rezulton se OE nuk plotëson në kriteret e vecanta për kualifikim **2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf teknik të pajisur me certifikata të sigurimit teknik të leshuara nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si dhe të rezultojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën **Korrik 2023 – Shtator 2023** minimalisht si më poshtë:

- Punonjës Teknik ndërtimi 2 (dy)
- Punonjës hidraulik 2 (dy)
- Punonjës murator 3 (tre)
- Punonjës Bojaxhi 1 (nje)
- Punonjës Saldator 3 (tre)
- Punonjës Hekurthyes 2 (dy)
- Punonjës Elektracistë 3 (tre)
- Punonjës Pllakashtrues 3 (tre)

Për punonjësit e kualifikuar si më sipër, ofertuesi duhet të paraqesë :

- Kontratën individuale të punës;
- Certificate të sigurimit Teknik e vlefshme, leshuar nga institucione të autorizuara nga /ish (IQT) e cila të jete e leshuar nga shoqëri të akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë
- Operatori ekonomik të paraqes deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

**Tab.1**

Nr	Emer Mbiemer	Profesioni	Data e fillimit marredhenieve punes	Nr. Amzes/ekuivalent diplomes/certifikates profesionale	Institucioni/Subjekti certifikues	Data vlefshmerise se certifikates profesionale

**Kriteri sipas pikes 2.3.4 do të përmbushet nga OE me anë të plotësimit të Formularit**

**Përmbledhës së Vetëdeklarimit dhe tabelës Tab.1.** Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në

klasifikim duhet te dorezojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit , të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

***Autoriteti Kontraktor rezervon të drejten të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.***

Nga verifikimi i dokumentacionit te operatorit ekonomik konstatohet se:

Operatori ekonomik Lis Konstruksion shpk ka deklaruar ne formularin përmbledhës të vetdeklarimit

Ne permbushje te pikes 2.3.4 ka deklaruar ne formularin permbledhes se vetdeklarimit 1 punonjës saldator Z.Q H, punonjws murator M.K dhe punonjws elektrikist L.M. pajisur me certificate kualifikimi nga HSEM, L62430006B. OE nuk ploteson piken 2.3.4 pasi nuk ka paraqitur staf teknik punonjës te pajisur me certifikata te sigurimit teknik të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione te autorizuar nga /ish (IQT) te jete e leshuar nga shoqeri te akredituara nga DPA ose nga organizmat nderkombetare akreditues te njohur nga Republika e Shqiperise. Subjekti HSEM L62430006B nuk eshte i pajisur me License per te ofruar kurset e trajnimit saldator, murator, elektrikist. **Këtë qëndrim ka mbajtur e edhe KPP në vendimin nr. 745/2022 në lidhje me dëshmitë e lëshuara nga subjekte të pa licensuara.**

## **6. Bashkimi i Operatorëve (BOE)**

**“ABG Ndertim”shpk me Nuis K038164010 dhe “EVEREST”shpk me Nuis J78311921L**

Vlera e ofruar/Totali i çmimeve për njësi dhe vlera e pritshme e kontratave (nëse është e zbatueshme) **16,936,619.23 (gjashtëmbëdhjetë milion e nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëmbëdhjetë.23) lekë pa TVSH.**

### **1. Ne kriteret e vecanta per kualifikim, kapaciteti teknik pika 2.2.1 percaktohet:**

**2.2.1.** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare ( 2020,2021,2022) , të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika ”c” të Ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Nga verifikimi i dokumentacionit te paraqitur nga ABG Ndertim si anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik konstatohet se operatori ekonomik nuk ka paraqitur bilancin e vitit 2020 duke mos plotesuar Kriteret e vecanta per kualifikim kapaciteti teknik pika 2.2.1.

2. Referuar dokumentacionit te dorezuar ne SPE bashkimi i operatorëve ekonomik konstatohet se BOE nuk ploteson pike 2.1.b Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; Në udhëzime për operatorët ekonomikë është kërkuar periudha e vlefshmerisë së ofertës 150 (njëqind e pesëdhjetë) ditë. Nga verifikimi i Formularit të sigurimit të ofertës të paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomik ABG Ndertim shpk & Everest shpk konstatohet se sigurimi i nuk ploteson periudhen e vlefshmerise se ofertes 150 dite, pasi sigurimi ofertes



se dorëzuar është leshuar në datë 08.11.2023 dhe është i vlefshëm për 150 ditë. Në DT sigurimi i ofertës duhet të jetë i vlefshëm për 150 ditë e përlogaritur duke filluar nga data e hapjes së ofertave pra duhet të fillonte me datë 10.11.2023 dhe të deklarohet i vlefshëm për 150 ditë nga kjo datë.

Në udhëzime për operatorët ekonomikë përcaktohet specifikisht:

*Ofertat do të jenë të vlefshme për periudhën e specifikuar në Njoftimin e Kontrates pas afatit të paraqitjes së Ofertave të përcaktuara nga Autoriteti/Enti Kontraktor; Oferta për një periudhë më të shkurtër nuk është e vlefshme dhe do të refuzohet.*

Sa më sipër bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur periudhë më të shkurtër vlefshmërie se periudha e kërkuar në dokumentat e tenderit dhe për rrjedhojë sigurimi i ofertës nuk është i vlefshëm.

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **LUEM TRADE & CONSTRUCTION TRADE & CONSTRUCTION shpk** me Nuis **L42215023A** dhe **VELLEZERIT HYSA shpk** me Nuis **K12911201C** se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **16,498,999.00** (gjashtëmbëdhjetë milion e katërqind e nëntëdhjetë e tetë mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH /pikët totale të marra [\_\_\_\_\_] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **BASHKIA VLORË** sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzon sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik".

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO  JOX

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Ermal DREDHA**



